

STATUT
I SHOQERISE MË PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

“Rubix Power Networks Groups” sh.p.k.

KAPITULLI I
EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1- Forma

Shoqeria tregtare (më poshtë shenuar “shoqeria”), krijohet ne formën e nje shoqerie tregtare më pergjegjesi të kufizuar. Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti i Themëlimit dhe legjistacioni shqipetar ne fuqi.

Akti i themëlimit dhe Statuti jane ne perputhje më legjislacionin shqiptar dhe çdo çeshtje e paparashikuar shprehimisht ne to, rregullohet sipas legjislacionit shqipetar ne fuqi.

Neni 2-Emërtimi

Shoqeria emërtohet **“Rubix Power Networks Group” sh.p.k.** Emërtimi i shoqerise mund të shkruhet më shkronja të mëdha ose të vogla.

Neni 3-Selia

Selia zyrtare e shoqerise ndodhet ne **Torre Drin Rrugen, “Abdi toptani”, Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane.** Shoqeria sipas parashikimëve të ketij statuti dhe legjislacionit ne fuqi, mund të hape si ne Shqiperi dhe jashtë saj, qendra, perfaqesi, filiale, dege dhe shoqeri të tjera.

Neni 4- Kohezgjatja

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqerise do të jetë pa afat, duke filluar prej datës se rregjistrimit të saj ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare prane Qendes Kombetare të Rregjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet nje ose më shumë here, më vendim të asamblese se ortakeve.

Neni 5- Objekti i veprimtarise

Objekti i shoqerise eshtë si më poshtë:

Investimi ne instrument financiar (te cilet perfshijne pa kufizime titujt e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat ne fonde investimesh etj), investimi ne pasuri te paluajtshme dhe ne asete (te prekshme apo te paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i sherbimeve te konsulences per shoqerite e kontrolluara prej saj dhe/ose te trete (te cilet perfshijne pa kufizime konsulencen e natyres financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj.)

ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, Gjithashtu, shoqeria mund te kryej cdo veprim, operacion apo transakcion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundersizim dhe mos alterojne objektin paresor Administratori/et perfaqeson/jne ligjerisht shoqerine. Administratori ushtron te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te Shoqerise, ne perputhje me nenin 95 te Ligjit nr 9901. date 14 mars 2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme. Per me shume qartesi, Administratori/et, pervec kompetencave te parashikuara ne ligjin per shoqerite tregtare te sipershenuar, permes ketij Statuti, ka/ne te drejte vendimmarrje:

- a. per krijimin e Joint Venture dhe bashkepunimeve te cilit do lloji qofshin, qe kane te bejne me investim, financimin, fitim te drejtash apo pjesemarrjesh ne projekte ekzistuese apo te reja
- b. per shitjen, blerjen apo shkembimin e pasurive te paluajtshme dhe nenshkrimin e kontratave te sipermarrjes ne lidhje me to te barabarte, per te angazhuar shoqerine, ne cilesine e kredimarrses, ne marredhenie kredie, perkundrejt institucioneve financiare te licensuara ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, me tagra te plota dhe te pakufizuara, persa i perket shumave, kushteve, afateve te kredise si dhe ne pergjithesi per te angazhuar Shoqerine, me tagra te plota dhe te pakufizuara, ne amendimet e marredhenieve ekzistuese te kredimarrjes, perfshire por pa u kufizuar ne amendimin e shumave, kushteve dhe afateve, duke percaktuar ne cdo rast, lirisht, permbajtjen e kontratave apo akteve te lidhura me kredimarrjen e Shoqerise, duke pasur te drejte te nenshkruaje cdo kontrate te re kredie, amendim te kontratave ekzistuese te kredise, rinovim, riskedulim, ristrukturim, apo cdo dokument ose formular te kerkuar nga institucionet financiare, me te cilat shoqeria eshte ne marredhenie kredimarrje;
- d. per vendosjen e barreve apo kufizimeve mbi pasurite e luajtshme dhe/ose te paluajtshme te shoqerise ne favor te te treteve;
- e. per dhenien e garancive te cilit do lloji dhe angazhimin e shoqerise ne cilesine e garantorit dhe/ose dorezanesit (corporate guarantee) kundrejt te tjereve ne favor te te treteve;
- f. per te perfaqesuar shoqerine, me tagra te plota dhe te pakufizuara, permes votimit ne cdo mbledhje asambleje ku shoqeria paraqitet si ortak apo aksioner, duke vendosur lirisht menyren e votimit, pa asnje kufizim te lidhur me ceshtjet e ngritura ne keto mbledhje asambleje, perfshire por pa u kufizuar edhe vendimmarrjen me tagra te plota dhe te pakufizuara per ceshtje te njejta me ato te listuara ne pikat e mesiperme (c,d,e).

Ne sferen e import export tregetim dhe furnizim me shumice e pakice shitblerjes se energjise elektrike. Ndertimi dhe zhvillim i impjanteve sistemeve te prodhimit shperndarjes trasmetimit te energjise elektrike, ofrimi i sherbimeve te konsulences, projektimin inxhinerik dhe asistences teknike, sherbim bankar dhe financiar zhvillim menaxhim, sherbimit turistik ne lidhje edhe me shoqeri te transportit rrugor, uxor dhe ajror do te kryeje sherbimin e transportit per pasagjer dhe mallra, sherbime turistike ne te gjithe boten, shitje, blerje e dhenie me qera te pasurive te luajtshme. Tregtim te bimeve dhe pemeve dekorative frutore, si dhe

matërialeve e impjantëve të vaditjes dhe konservimit të tyre. Zhvillim aktiviteti ne agroturizem dhe ne cdo veprimetari tjetër qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 6- Përgjegjësia

Shoqeria nuk përgjigjet për detyrimët e marra për qëllimë që nuk përputhen më ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themëlimit. Shoqeria nuk përgjigjet për detyrimët e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave fizike, juridike, privat ose publik, brenda ose jashtë shtetit.

K A P I T U L L I I I

KAPITALI I RREGJISTRUAR, KONTRIBUTËT, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Neni 7- Kapitali Rregjistruar

Kapitali fillestar i rregjistruar i shoqërisë është 100 000 leke (Njëqindemije) leke. Ai do të krijohet nga themeluesit më kontributë në para .

Neni 8- Kuotat e Kapitalit të Rregjistruar

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje më kontributët e tyre të mëposhtmë:

Ortakët themelues, kanë kontribuar një kapital në para në shumën 100 000 leke dhe zotërojnë

- 1- *Benito Dokji* lindur me 13.10.1969 në shkup Maqedoni me numer pasaporte nr.C1166155 30% (tridhjetë për qind),
- 2- *Alen Vodanovic* Lindur në Makarska me 07.08.1970 me numer pasaporte nr.050660023 30% (tridhjetë për qind),
- 3- *Daniel Jason Teri* Lindur në Brighton me 03.11.1972 me numer pasaporte nr.5347477884 nga 30%
- 4- *Edmond Petraj* Lindur në Fier me 03.10.1964 me karte identiteti nr. G41003041R 10% (dhjetë për qind) të kuotave të kapitalit të rregjistruar të shoqërisë.

Neni 9- Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimëve

Në përputhje më dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emëtohen më të drejtat ose kufizimet e parashikuara

në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

Neni 10- Certifikatat e kuotave

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të otëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës më vlerë.

Neni 11- Kalimi më Kontratë i Kuotave

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet më shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratorët. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

Administratorët mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratorët nuk janë dakord më personin të cilit i kalon kuota.

Nëse Administratorët refuzojnë të regjistrojnë kalimin e kuotës, ata do të njoftojnë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

Neni 12- Kalimi i kuotave më Trashëgimi ose si pasojë e Falimëntimit

Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku më persona të tjerë.

Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimëntimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.

Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimëntimit të një ortaku do të këtë të drejtat që gëzontë zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të

drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

Neni 13- Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themëltar

Asambleja e Përgjithshme, më shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themëltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit më qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme më shumicën e kualifikuar të votive të ortakëve.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themëltar të shoqërisë më vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë më shumicën e kualifikuar të votave.

Neni 14- Blerja e Kuotave të Veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emëtimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtët për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen.

Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje më kushtët e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim më parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRIMI, KONTROLLI

Neni 15- Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi më shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, më njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi më shkresë apo më mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 16- Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm më arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjetëve elektronike, përfshirë telekonferencën

(conference call), audio ose audio-video, në përputhje më nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë më mjetë komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku më njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.

Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe më të drejtë votë zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes

Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Kryetari, më pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje më kuorumin e caktuar më ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj datë dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.




Asambleja vendos më votim të hapur më përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga: 1. Kryetari; ose 2. një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themëltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë më kërkesën e paraqitur nga vetë ortakut.

Më përjashtim të kundërshtimit të një ortakut, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marre në mënyrë unanime, ose më një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar më një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

Në rast se ka kundërshtimë për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë nëlidhje më përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 17: Votat e Ortakëve

Në përputhje më të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një votë.



Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 18- Votimi me Prokurë

Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës që miratohet nga Administratori i shoqërisë ose prokure përfaqësimi.

Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e notërizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë, duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 19- Hetimët e posaçmë

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklaratë notëriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Neni 20- Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta dhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e zakonshme. Administratori/et qendrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiare, me mundësi për tu rizgjedhur.

Administratori/et kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhenie më të tretët, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti ja jep Asamblesë së Ortakeve.

Administratori i parë i shoqërisë është **z. Benito Dokji**, shtetas Maqedonas, lindur në Shkup më datë 13.10.1969, me adresë vendqendrimi në Shqipëri në *Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane*. Administratori do të ndjeke të gjitha procedurat e nevojshme për rregjistrimin e shoqërisë në Qendren Kombëtare të Rregjistrimit (QKR) me përfaqësuesin ligjor të shoqërisë *Avokat Edmond Petraj Bulevardi "Gjergji fishta" Pallati "Delta-1" Tirane me Prokurë të përgjithshme Nr.rep 3601 dhe Nr.kol.1213 date 22.10.2021*

Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 21- Ekspertët Kontabel të Autorizuar.

Shoqëria do të kontrollohet nga një ose disa ekspertë kontabel të autorizuar të zgjedhur nga lista e Institutit të Ekspertëve Kontabel të Autorizuar. Në caktimin e ekspertëve kontabel të autorizuar mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e percaktuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Eksperti/et kontabel të autorizuar emërohen nga asambleja e përgjithshme, në afatët e parashikuara nga ligji, më të drejtë rizgjedhje në kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme.

Detyrimet dhe të drejtat e Ekspertëve Kontabel të Autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatët e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMËVE

Neni 22- Viti financiar dhe bilanci vjetor.

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar, pranë Qendës Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë dhe përfundon në 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Pasqyrat financiare, raporti i administrimit dhe raporti i ekspertit/ve kontabel të autorizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme në kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme.

Miratimi i dokumentave që lidhen më vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 23- Dividendët

Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria më shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve nëpërputhje më të drejtat përkatëse të ortakëve.

Më përjashtim të rastëve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen më kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje më shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë më shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emëtohet më

kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë ecaktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesë ndajshoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data ematurimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja ePërgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajëatë.

Neni 24- Kalimi i Fitimëve në Kapitalin Themëltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themëltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

KAPITULLI I V

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 25- Prishja, Likujdimi

Perjashtuar rastin e nje prishje me vendim gjyqi e parashikuar nga ligji, shoqeria mund të priset ne çdo kohe, me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar se votave të Asamblesë së Përgjithshme.

Pervec rastit të bashkimit ose të ndarjes, prishja e shoqerise per cfardo shkak u qoftë sjell likujdimin e saj. Likujdimi kryet nga nje ose disa likujdatore të emëruar nga Asambleja, të cilet kryejne këtë detyre ne perputhje statutin e shoqerise, ligjin "Per tregtaret dhe shoqeritë tregtare" dhe kerkesat e tjera ligjore.

Likujdatori perfaqeson shoqerine. Ai ka kompetënca të plota per të shitur aktivet e shoqerise, per të shlyer kreditorët dhe per të shperndare mbetjen e disponushmë ne perpjestim me pjeset e ortakeve ne kapitalin e rregjistruar.

Më perfundimin e procedures se likujdimit të Shoqerise, Asambleja do të vendose, me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar se votave, mbi bilancin financiar perfundimtar mbi vlefshmërine e punes se kryer nga likujduesit dhe mbi perfundimin e procesit të likujdimit.

Neni 26- Transformimi i Shoqerise.

Shoqeria mund të ndyshoje formën e saj ligjore nepermjet shnderrimit, ne perputhje me kerkesat e nenit 228 të ligjit "Per tregtaret dhe shoqeritë tregtare",

më vendimin të Asamblesë së Përgjithshme të marrë më shumicën e kualifikuar së votave.

Neni 27-Kundershtimët

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, midis ortakëve ose një apo më shumë prej tyre dhe shoqërisë, do të diskutohen në mënyrë të drjetperdrejtë midis të interesuarëve për të zgjidhur miqësisht. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 28- Shpenzimet.

Të gjitha shpenzimet e kryera përpara firmosjes së statutit dhe ato midis datës së firmosjes së statutit e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregëtar, janë shpenzime që do perballohen nga shoqëria.

Neni 29- Të tjera

Ky Statut - Akt Themelimi i shoqërisë me përgjeksi të kufizuar **Rubix Power Networks Group - sh.p.k.** përpilohet në pesë (5) kopje në gjuhën shqipe dhe angleze dhe hyn në fuqi menjëherë.


TIRANE ME 10.12.2021

ORTAKET THEMËLUES


I SHOQËRISE MË PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

“Rubix Power Networks Group” sh.p.k.


Benito Dokji



Daniel Jason Teri



Edmond Petraj



Alen Vodanovic

